

VENDIM
Nr. 272, datë 16.5.2018

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
“KOMBINATI I SHEQERIT” SHA, MALIQ, NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË
TE BASHKIA MALIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Kombinati i sheqerit” sh. a., Maliq, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Maliq, me të gjitha të drejtat e detyrimit, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi